

## **ANEKS MARREVESHJE**

### **Emertimi**

#### **FORUMI RAJONAL AFTEZIA E KUFIZUAR DHE INTEGRIMI, SHKODER FRAKISH**

*Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder deklaron se:*

Duke qënë të ndërgjegjshëm se personat me aftësi të kufizuar ende përballen me mosrespektimit të të drejtave të njeriut dhe formave shumëfishe të diskriminimit prezente këto edhe në Rajonin e Shkodrës, janë në kushte të vështira jetësore, kanë pamundësi të aksesit në ambientet fizike, shoqërore, shëndetësore, ekonomike, kulturore, arsimore në informacion e komunikim:

*bie dakord si më poshtë*

### **PJESA E PARË**

#### **Themelimi**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder është rrjet bashkëpunimi, me pjesëmarrjen e disa prej: Agjensive të Zhvillimit, OFJ- ve vendore në fushën e të drejtave të njeriut dhe aftësisë të kufizuar, media, Kompanive të Biznesit, Institucioneve lokale dhe rajonale dhe kërkuesve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit. Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder është rrjet i hapur që bashkon grupe të interesuara në çështjet e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit.

#### **Emërtimi**

Emërtimi i këtij rrjeti është Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder.

#### **Misioni**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder ka mision promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet bashkëpunimit aktiv, shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës nderdisiplinore ndërmjet anëtarëve të Forumit për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit në Shqipëri dhe më specifiksht në Rajonin e Shkodrës.

## **Objektivat**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të udhëhiqet nga këto objektiva të përgjithshëm:

1. Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder, nëpërmjet anëtarëve të tij do të lobojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftesi të kufizuar me synim gjithëpërfshirjen e çështjes së aftësisë të kufizuar, duke organizuar konferenca, seminare, takime apo tryeza të rrumbullakëta; botime raportesh e artikujsh dhe veprimtari te tjera.
2. Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të nxise bashkëpunimimin dhe shkëmbimin e eksperiencave midis anëtarëve të tij për ofrimin e mundësive në mbështetje teknike dhe financiare, seminare dhe trajnime për ngritje kapacitetesh të anëtarëve të koalicionit.
3. Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të shkëmbejë dhe shpërndajë informacion, ekspertizë dhe materiale të tjera ndërmjet organizatave anëtare dhe strukturave jashtë tij, duke organizuar:
  1. Takime të rregullta të Forumit te pakten cdo katër muaj.
  2. Përhapje e informacionit brenda organizatave anëtare të Forumit.
  3. Shkëmbim i informacioneve të organizatave anëtare.
  4. Ndertim i marredhenieve progresive ndertuar ne mirekuptim dhe debat midis anetareve perfaqesuesve te shoqerise civile dhe perfaqesuesve institucional.

## **PJESA E DYTË**

### **Funksionimi i Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder**

### **Organet drejtuese të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder**

Organet drejtuese të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder janë:

- Asambleja e anëtarëve
- Bashkëkryetarët

## **Asambleja e anëtarëve**

Asambleja e anëtarëve përbëhet nga të gjithë anëtarët nënshkrues të marrëveshjes së bashkëpunimit për krijimin e Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder Çdonjëri nga anëtarët e Asamblesë së anëtarëve ka të drejtë e një (1) vote.

Asambleja e anëtarëve ka për detyrë:

- Të miratojë dhe ndryshojë, objektivat e përgjithshëm si dhe politikat e Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder për ndërhyrjeje, përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, në përbushje të misionit të tij.
- Të zgjedhë Bashkëkryetarët.
- Të vendosë për pranimin dhe largimin e anëtarëve.
- Të miratojë dhe të ndryshojë këtë marrëveshje.

Çdo njëri nga anëtarët e Asamblesë së Anëtarëve ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim tek Bashkëkryetarët për të thirrur mbledhje, jashtë radhe, të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder për çështje që ata i konsiderojë të rëndësishme.

## **Bashkëkryetarët**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të ketë dy (2) Bashkëkryetarë, një prej të cilëve do të jetë organizatë apo përfaqësues qe eshte aktiv ne fushen e aftësisë së kufizuar.

Asambleja e anëtarëve, zgjedh Bashkëkryetarët, me votim të hapur, për një periudhë 6 mujore me të drejtë rizgjedhjeje.

Bashkëkryetarët do të zgjidhen nga Asambleja e anëtarëve te Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder , me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij, sipas procedurës të vendosur nga Asambleja e anëtarëve ditën e votimit.

Në 20 muajt e pare, nga krijimi i Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder, një nga bashkëkryetarët do të jetë Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta Shkoder. Pas mbarimit të këtij mandati do të fillojnë procedurat për zgjedhjen e bashkëkryetarit tjeter si parashikohet në këtë aneks marrëveshje.

### **Bashkëkryetarët kanë për detyrë:**

1. Të drejtojnë veprimtarinë ekzekutive të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder
2. Të drejtojnë mbledhjet e Asamblesë së anëtarëve.
3. Të thërrasin në mbledhje, takime, diskutime, konferanca, anëtarët e Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder detyrimisht jo më pak se 3 herë në vit.
4. Të raportojë për veprimtarinë ekzekutive në Asambleja e anëtarëve.
5. Te perfaqesoje Forumin Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder ne marredhenie me publikun.

Bashkëkryetarët vendosin me marrëveshje midis tyre për drejtimin e mbledhjeve të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder.

### **Anëtarësia Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve**

Anëtarë të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder janë organizatat që kanë firmosur marmrëveshjen e bashkëpunimit.

Anetare te Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder mund te behen me vendim te asamblese edhe individe qe ofrojne kontribut te posacme ne kete fushe.

Për të qenë veprues dhe efektiv, në 2 vitet e para të aktivitetit të tij, Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të ketë numër të kufizuar anëtarësh.

Anëtarët kanë të drejtë të përfaqësojnë Forumin Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder vetëm pasi është bërë njoftimi paraprak dhe është marrë miratimi i plotë i Asamblesë së Anëtarëve. Në rast se ndonjë prej anëtarëve do të përfaqësojë apo do të veprojë në emër të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder pa marrë miratimin e Asamblese se anëtarëve, kjo do të ndikojë në rishikimin e anëtarësisë të tij në grupim.

Anëtarët kanë të drejtë të qëndrojnë në Forum për aq kohë sa ata e mendojnë të dobishme dhe e shohin të nevojshme të bashkëpunojnë.

Anëtarët do të marrin pjesë në Forumin Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder duke kontribuar si më poshtë:

1. Ofrimin dhe sigurimin e mbështetjes për fuqizimin e Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder
2. Shkëmbim informacioni, praktikash apo eksperiencash përsa i përket çështjeve të aftësisë së kufizuar e zhvillimit.
3. Pjesëmarrje në takimet e planifikuara të Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder dhe në seminare e konferenca të anëtarëve të rrjetit.
4. Përfaqësimin e Forumit Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder në takime, organizime, konferenca apo evenete të tjera, por pasi është marrë miratimi i plotë nga Asambleja e anëtarëve.

### **Perfaqesimi**

Cdo antar ne kete Forum do te perfaqesohet nga personi i perzgjedhur nga organizata perkatese ose nga një person i autorizuar nga titullari i organizes.

### **Dorëheqja**

Anëtaret mund të tërhiqen nga Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder kurdoherë që e gjykojnë të arsyeshme, duke paraqitur qëndrimin e tyre me shkrim.

### **Perjashtimi**

Perjashtimi i anëtarëve te Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder mund te behet:

1. Ne rastin e shkeljes se detyrave sic percaktohen ne kete aneks marreveshje.
2. Mospjesmarrje ne tre mbledhje rradhazi te asamblese se anetaresise pa nje shkak te arsyeshem.

### **Kohëzgjatja**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të funksionojë për një periudhë kohe të pacaktuar.

### **Qëndrueshmëria**

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder do të funksionojë mbi baza donacionesh apo financime vullnetare të anëtarëve të Forumit.

### **MIRATUAN**

Sot në Shkodër, 23 Janar 2009

1. Qendra e Zhvillimit Shkoder Elvirë Koliqi Akuziqi
1. Edukimi i te Shurdhereve dhe Integrimi i tyre Rozore Protomi RT
2. "Melograno" Zelalem Tgofni Lulzim Poluri
3. Bashkia Shkoder Julia Cepi Lepis
4. "The Door" Albania Kastrriot Faci Elifac
5. SH. S. SH Zyra Rajonale Shkoder Perxhije Boke Buke Jup Shkel Club
6. Keshilli i Qarkut Shkoder Vilma Shiroka
7. Shkolla Speciale "3 Dhjetori" Tale Murishi

8. "Madonnina del Grappa" Djama Lekaj 'Shqip'
9. USH L. Gurakuqi/ Fakulteti i Drejtësise Lindu Durroj 'Cuf'
10. Shoqata e Prinderve Rrok Dako 'Brok'
11. Q. ZH..SH.B Nezire Sofi 'J' Edlira Grohovs 'Brok' 'Majja'
12. GTZ - Shkodër Shkodër
13. Media/ RTSH Adriam Hoti - tcc
14. Projekti Shpresa Chora Banda 'Banda'
15. Bella Confex sh.p.k Keti Basholli